

**VisionFund Albania**  
**Pasqyrat financiare**  
**më 31 dhjetor 2014**

**(me raportin e audituesve të pavarur bashkëngjitur)**

# Përmbajtja

---

Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Përmbledhëse	2
Pasqyra e Flukseve Monetare	3
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	4
Shënime për Pasqyrat Financiare	5 - 24



**KPMG Albania Shpk**  
"Dëshmorët e Kombit" Blvd  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524  
+355(4)2274 534  
Telefax +355(4)2235 534  
E-mail al-office@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Pronarit dhe Drejtimit të  
VisionFund Albania

Tiranë, 27 mars 2015

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të VisionFund Albania ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014, pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi ynë, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

### *Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2014, rezultatin e saj financiar dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Heris Jani  
Auditues i Gjor

KPMG Albania Sh.p.k.  
"Deshmoret e Kombit" Blvd.  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

# VisionFund Albania

## Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek)

	Shënime	2014	2013
<b>Aktivët</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	6	16,276	59,803
Hua dhe paradhënie për klientët	7	246,474	229,672
Aktivët afatgjata materiale	8	7,489	10,354
Aktive të tjera	9	1,720	2,086
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>271,959</b>	<b>301,915</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali i vet</b>			
<b>Detyrimet</b>			
Hua dhe qira financiare	10	211,987	220,557
Grante		2,250	5,691
Detyrime të tjera	11	2,552	3,124
		<b>216,789</b>	<b>229,372</b>
<b>Kapitali i vet</b>			
Kapitali aksionar	12	156,200	156,200
Humbje të mbartura		(95,713)	(78,340)
Rezerva të tjera		(5,317)	(5,317)
		<b>55,170</b>	<b>72,543</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe Kapitali i vet</b>		<b>271,959</b>	<b>301,915</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# VisionFund Albania

## Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse

### Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(Shumat në mijë Lek)

	Shënime	2014	2013
Interesa			
Të ardhura nga interesi	13	69,243	64,815
Shpenzime për interesa	13	(24,318)	(19,334)
Të ardhura neto nga interest		<b>44,925</b>	<b>45,481</b>
Të ardhura të tjera	14	11,368	9,094
Shpenzime operative			
Zhvlerësimi	8	(3,440)	(3,426)
Shpenzime personeli	15	(34,696)	(34,773)
Humbje nga zhvlerësimi i huave	7	(8,178)	(9,081)
Shpenzime të tjera	16	(17,559)	(20,802)
(Humbja)/fitimi neto nga kurset e këmbimit		(9,793)	3,017
Totali i shpenzimeve operative		<b>(73,666)</b>	<b>(65,065)</b>
<b>Humbja përpara tatimit</b>		<b>(17,373)</b>	<b>(10,490)</b>
Tatim fitimi	17	-	-
<b>Humbja për vitin</b>		<b>(17,373)</b>	<b>(10,490)</b>
Të ardhura të tjera përmbledhëse, pas tatimit		-	-
<b>Totali i humbjes përmbledhëse për vitin</b>		<b>(17,373)</b>	<b>(10,490)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# VisionFund Albania

## Pasqyra e flukseve të monetare

### Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(Shumat në mijë Lek)

	Shënime	2014	2013
<b>Flukset monetare nga aktivitete operacionale</b>			
Humbja për vitin		<b>(17,373)</b>	<b>(10,490)</b>
<i>Korrigjime për rakordimin e ndryshimeve të aktiveve neto ndaj mjeteve monetare neto nga aktivitetet operative:</i>			
Zhvlerësimi	8	3,440	3,426
Humbje nga zhvlerësimi i huave	7	8,178	9,081
Të ardhura nga interesi	13	(69,243)	(64,815)
Shpenzime për interesa	13	24,318	19,334
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operacionale:			
Ndryshime në huatë për klientë		114,325	118,102
Ndryshime në aktive të tjera		366	677
Ndryshime në detyrime të tjera		(572)	(11,069)
		<b>63,439</b>	<b>64,246</b>
Interesi i arkëtuar		(70,063)	(65,331)
Interesi i paguar		(23,972)	(19,185)
Tatimi i paguar		-	-
<b>Flukset monetare të përdorura në aktivitete operacionale</b>		<b>(30,596)</b>	<b>(20,270)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitete investuese</b>			
Shtesa neto në aktivet afatgjata materiale		(575)	(856)
<b>Flukset monetare përdorur në aktivitete investuese</b>		<b>(575)</b>	<b>(856)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitete financuese</b>			
Fonde të marra hua dhe si qira financiare		(8,915)	45,753
Fonde të marra nga grante		(3,441)	646
<b>Flukset monetare (përdorur ne)/ nga aktivitete financuese</b>		<b>(12,356)</b>	<b>46,399</b>
(Ulja)/ rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to		(43,527)	25,273
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit		<b>59,803</b>	<b>34,530</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit</b>	<b>6</b>	<b>16,276</b>	<b>59,803</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# VisionFund Albania

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

(Shumat në mijë Lek)

	Kapitali aksionar	Humbje të mbartura	Rezerva të tjera	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2013</b>	<b>156,200</b>	<b>(67,850)</b>	<b>(5,317)</b>	<b>83,033</b>
<i>Transaksionet me pronarët të regjistruara ne kapital</i>				
Kontributi nga pronarët	-	-	-	-
Kontributi total nga pronarët	-	-	-	-
<i>Totali i humbjeve përmblëdhëse</i>				
Humbje për vitin	-	(10,490)	-	(10,490)
Të ardhura të tjera përmblëdhëse, pas tatimit	-	-	-	-
Totali i humbjeve përmblëdhëse për vitin	-	(10,490)	-	(10,490)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2013</b>	<b>156,200</b>	<b>(78,340)</b>	<b>(5,317)</b>	<b>72,543</b>

### *Transaksionet me pronarët të regjistruara ne kapital*

Kontributi nga pronarët	-	-	-	-
Kontributi total nga pronarët	-	-	-	-

### *Totali i humbjeve përmblëdhëse*

Humbje për vitin	-	(17,373)	-	(17,373)
Të ardhura të tjera përmblëdhëse, pas tatimit	-	-	-	-
Totali i humbjeve përmblëdhëse për vitin	-	(17,373)	-	(17,373)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2014</b>	<b>156,200</b>	<b>(95,713)</b>	<b>(5,317)</b>	<b>55,170</b>

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 5 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Drejtimi ka autorizuar pasqyrat financiare më 25 Mars 2015:

Ervin Pecuni

Chief Executive Officer



Daniela Qyra

Finance Manager

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

---

### 1 Entiteti raportues

VisionFund Albania Sh.p.k (“Shoqëria”), është institucion mikrofinanciar i vendosur në Tiranë. Shoqëria është regjistruar ne Shqipëri në vitin 2007. Aktiviteti i mikrofinancës është transferuar tek Shoqëria si rezultat i ndarjes së këtij aktiviteti nga World Vision Albania (“WVA”). Shoqëria është në pronësi të VisionFund International (“Mëma”)

Në 31 dhjetor 2014, Shoqëria operonte nëpërmjet zyrës së saj qendrore në Tiranë dhe tre degëve të cilat ndodhen në Lezhë, Korcë dhe Elbasan, dhe dy njësi, një në Lac (nën administrimin e Lezhës) dhe një në Librazhd (nën administrimin e degës Elbasan).

### 2 Bazat e përgatitjes

#### (a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë së biznesit (Shiko Shënimin 5(i)).

#### (b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### (c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë. Informacioni financiar i prezantuar në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveçse kur shprehet ndryshe.

#### (d) Përdorimi vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen. Informacion mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël, që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në shënimin 5.

### 3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

#### (a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja që vjen nga konvertimet njihet në humbje ose fitim nën emërtimin “E ardhura/ (humbja) neto nga kurset e këmbimit”. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përveç kapitalit, që maten me kosto historike konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, përveç kapitalit, që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë.

#### (b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në humbje ose fitim bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme gjatë një periudhe më të shkurtër kohore) deri në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit është vendosur gjatë njohjes për herë të parë të aktivitetit financiar dhe mund të rishikohet bazuar në termat e marrëveshjes.

Norma efektive e interesit për detyrimet financiare vendoset gjatë njohjes për herë të parë të detyrimit dhe rishikohet më vonë bazuar në termat e marrëveshjes. Logaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet dhe pikët e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, dhe diskauntet apo primet që janë pjesë e rëndësishme përbërëse e interesit efektiv. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, nxjerrjes ose shitjes së aktivitetit ose detyrimit financiar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje ose fitim përfshijnë interesin nga aktivitetet dhe detyrimet financiare me kosto të amortizuara mbi bazën e interesit efektiv.



# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (c) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet shkaktohen nga shërbimet financiare që ofrohen nga Shoqëria. Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet njihen në momentin që ofrohet shërbimi. Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Kur angazhimi për një hua nuk pritet të rezultojë në tërheqje të huase, tarifat e komisionit njihen në mënyrë lineare gjatë periudhës së marrëveshjes. Shpenzime të tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me tarifat e transaksioneve dhe shërbimeve. Këto tarifa shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

#### (d) Aktive të marra me qira

Qiratë në terma të të cilave Shoqëria merr të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë, klasifikohen si qira financiare. Në njohjen fillestare, aktivi i marrë me qira matem me një shumë të barabartë me vlerën më të ulët mes vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pas njohjes fillestare, aktivi kontabilizohet në përputhje me politikën kontabël i aplikueshëm për atë aktiv.

Qiratë e tjera janë qira operative dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë. Pagesat e kryera për qiranë operative njihen në humbje ose fitim me metodën lineare gjatë periudhës së qirasë.

#### (e) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në humbje ose fitim përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në keto raste tatim fitimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet lidhur me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare. Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe atij të shtyrë Shoqëria merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të paqarta dhe nëse do të lindin detyrime shtesë tatimi dhe interesi. Shoqëria beson se përlllogaritjet e saj për detyrimet tatimore janë të përshtatshme për gjithë vitet tatimore të hapura, bazuar në vlerësimin e saj të shumë faktorëve, duke përfshirë interpretimet e legjislacionit tatimor dhe eksperiencës së mëparshme. Ky vlerësim mbështetet në përafrime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh për ngjarje të ardhshme. Për shkak të informacioneve të reja që mund të vihen në dispozicion, Shoqëria mund të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimin tatimor në periudhën kur është bërë një përcaktim i tillë.

Një tatimi i shtyrë aktiv njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit aktivi të mund të përdoret. Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe nuk njihet nëse nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

#### (f) Aktivitet dhe detyrimet financiare

##### (i) Njohja

Shoqëria fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tij. Ndërkohë që kostot e transaksionit për ato instrumente që në vazhdim vlerësohen me vlerë të drejtë kundrejt të ardhurave dhe shpenzimeve nuk përfshihen në vlerën fillestare të regjistruar të instrumentit por shpenzohen menjëherë.

##### (ii) Klasifikimi

Referohu politikave kontabël 3(g),(h) dhe (j).

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

---

### 3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

##### (iii) *Mosnjohja (Çregjistrimi)*

Shoqëria nuk njih më një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur ajo i transferon të drejtën kontraktuale për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivi financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet e pronësisë së aktivit financiar. Interesi nga aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose e mban Shoqëria njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria nuk njih një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Shoqëria merr pjesë në transaksione më anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi konvergjuese, transaksioni konsiderohet si një transaksion financiar i siguar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në disa transaksione të caktuara ku Shoqëria as nuk ruan dhe as nuk transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, ajo nuk e njih aktivin nëse nuk ruan kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet e ruajtura gjatë transferimit njihen me vete si aktive ose detyrime (sipas rastit). Në transferime ku kontrolli mbi aktivin ruhet, Shoqëria vazhdon të njohë aktivin sipas shkallës së përfshirjes së vazhdueshme të saj në aktivin financiar, e përcaktuar kjo nga masa e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

##### (iv) *Netimi*

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen dhe vlera e tyre paraqitet neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm, dhe vetëm, nëse Shoqëria ka të drejtë ligjore t'i netoje dhe ka qëllim që të shlyejë në baza neto ose të fitojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në baza neto vetëm kur kjo lejohet nga standardet e kontabilitetit.

##### (v) *Matja me kosto të amortizuar*

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar dhe duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvleresimi.

##### (vi) *Matja me vlerë të drejtë*

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim mund të vendoset midis palëve që kanë njohurinë dhe mundësinë të kryejnë transaksione në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes. Kur është e mundshme, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur cmimet e kuotuar për këtë instrument në tregje aktive. Një treg konsiderohet aktiv nëse cmimet e kuotuar janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe paraqesin transaksionet aktuale dhe të rregullta të tregjeve në bazë të marrëdhënieve normale në treg.

Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Shoqëria bën matjen me vlerën e drejtë duke përdorur metodën e vlerësimit. Metodën e vlerësimit përfshijnë metodën e vlerës aktuale neto, flukset monetare të skontuara, krahasime me instrumenta financiare të ngjashëm për të cilët ekzistojnë cmime të vëzhgueshme në treg dhe metoda vlerësimit. Për keto instrumente financiare, të dhënat e përdorura në model nuk janë të vëzhgueshme.

### **3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **(f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

##### *(vii) Identifikimi dhe matja e zhvleresimit*

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvleresohen nëse evidencë objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Evidencat objektive që aktivet financiare janë të zhvleresuara mund të përfshijnë mospagesa ose vështiresi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një huaje me kushte dhe afate të cilat Shoqëria nuk do t'i kishte dhënë ndryshe, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me mospagesa të grupit. Shoqëria konsideron evidencën e zhvlerësimit si individualisht ashtu edhe në mënyrë kolektive. Huatë në nivel kolektiv zhvlerësohen duke grupuar së bashku huamarrësit që kanë karakteristika të ngjashme krediti. Huatë të cilat zhvlerësohen në mënyrë individuale identifikohen duke u bazuar në evidencë objektive që niveli i tyre i rrezikut të kalojë nivelin historik të rrezikut të huave si për shembull rastet e ristrukturimit, humbjeve, kushteve të përkeqësuar ekonomike dhe delinkuencës.

Per vlerësimin e fondit të zhvlerësimit të kredive në nivel kolektiv Shoqëria përdor modele statistikore të përvojës historike të humbjes, periudhën e rimarrjes dhe vlerën e humbjes. Zhvlerësimi individual bazohet në kolateralin e vendosur për huanë, evidencat e flukseve të parasë për shlyerjen e huasë, gjykimin të manaxhimit mbi kushtet aktuale ekonomike, vlerës së kolateralit nëse ka, dhe klasifikimi i huave të portofolit. Drejtimi beson se këto fonde zhvlerësimi janë të përshtatshme për humbjet nga huatë përbërëse të portofolit. Zhvlerësimi i huave ngarkohet kundrejt të ardhurave dhe zbritet nga shuma total e humbjeve.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare të skontuara më normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në humbje ose fitim dhe pasqyrohen në një llogari zhvlerësimi përkundrejt huave dhe paradhënive. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zvogëlimi anulohet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave. Shoqëria fshin ato hua dhe paradhënie të klientëve të cilat janë përcaktuar si të pambledhshme (shiko shënimin 4).

#### **(g) Mjete monetare dhe ekuivalente me to**

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartemonedha dhe monedha në arkë, gjendje të pakushtëzuara në Banka dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

#### **(h) Hua dhe paradhënie**

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Shoqëria nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhën afatshkurtër.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht matën me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **(i) Aktivet afatgjata materiale**

##### *(i) Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe koston e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur. Kur pjesë të ndryshme të një aktivi afatgjat material kanë jetegjatesinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (i) Aktivet afatgjata materiale

##### (ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në humbje ose fitim në momentin kur ndodhin.

##### (iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet mbi shumën e zhvlerësueshme e cila është kostoja e aktivit pa vlerën e mbetur. Zhvlerësimi njihet në humbje ose fitim duke përdorur metodën mbi vlerën e mbetur. Toka nuk zhvlerësohet. Normat vjetore të zhvlerësimit janë si më poshtë:

- |                       |     |
|-----------------------|-----|
| • Automjete           | 20% |
| • Pajisje dhe mobilje | 20% |
| • Kompjuterat         | 25% |

#### (j) Huatë

Huatë e marra janë burimi i borxhit të Shoqërisë që në fillim maten me vlerën e drejtë dhe në vijim vlerësohen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### (k) Grantet

Grantet fillimisht njihen si e ardhur e shtyre me vlere te drejte kur ka siguri te arsyeshme se ato do te pranohen dhe Shoqëria do te zbatonte te gjitha kushtet shoqeruese te grantit, dhe njihen pastaj ne pasqyren e fitimit ose humbjes si te ardhura ne baza sistematike pergjate jetes se dobishme te aktivitetit. Grantet qe kompensojne Shoqërinë për shpenzime të kryera njihen në fitim ose humbje si e ardhur ne baza sistematike pergjate periudhave në të cilat njihen shpenzimet.

#### (l) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktiviteti. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje ose fitim.

Vlera e rikuperueshme e një aktiviteti është më e madhja ndërmjet vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejte minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parë dhe risqet specifike për aktivitetin. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura më parë vlerësohen në çdo raportim nëse humbja është zvogëluar ose nuk ekziston më. Një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka patur ndryshim në vlerësimet për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin, sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

#### (m) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohej një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parë dhe, sipas rastit, risqet specifike të detyrimit.

### 3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### (n) Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sjellin përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të siguruar prapen minimal ligjor për pensionet në Shqipëri nën një plan të përcaktuar pensioni. Kontributet e Shoqërisë për planin e përfitimit të pensionit regjistrohen në humbje ose fitim atëherë kur ndodhin.

#### (o) Standarde dhe interpretime të reja ende të paadoptuara

Një numër standardesh të reja, amendime apo interpretime të tyre ende nuk janë bërë efektive për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2014, dhe nuk janë aplikuar që herët në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnje nga këto nuk pritet të adoptohet më herët se data efektive në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

#### **SNRF 9 Instrumentet Financiare**

SNRF 9, e publikuar në korrik 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues në SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin udhëzimet e rishikuara mbi klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë një model të ri mbi humbjet e pritshme për llogaritjen e provigjonit të aktiveve financiare, si dhe kërkesat e reja të përgjithshme mbi kontabilitetin mbrojtës. Standardi gjithashtu përmban udhëzime mbi njohjen dhe cregjistrimin e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 është efektive për periudhat raportuese të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2018, ku zbatimi i mëparshëm është i lejuar.

Shoqëria ka filluar procesin e vlerësimit të ndikimit potencial mbi pasqyrat financiare nga aplikimi i SNRF 9-ës. Duke marrë parasysh natyrën e operacioneve të Shoqërisë, ky standard pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Standardet e reja apo të ndryshuara më poshtë nuk pritet të kenë efekt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët
- Planet me Përfitime të Përcaktuara: Kontributet e Punonjësve (Ndryshime të SNK 19)
- SNRF 14 Llogaritë e Shtyra Rregullatore
- Kontabiliteti për Blerjet Interesave në Operacionet e Përbashkëta (Ndryshime të SNK-ve 16 dhe 38)
- Bujqësia: Bimët Prodhuese (Ndryshime të SNK 16 dhe SNK 41)
- Metoda e Kapitalit në Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshime të SNK 27)
- Shitjet ose Kontributet në Aktive ndërmjet një Investitori dhe Pjesëmarrjeve të tij apo Sipërmarrjeve të tij të Përbashkëta (ndryshime të SNRF 10 dhe SNK 28).

### 4 Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional.

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektive, politikave dhe proceseve të Shoqërisë për matjen dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit.

#### **Struktura e administrimit të rrezikut**

Drejtimi i Shoqërisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut në Shoqëri. Drejtimi ka përgjegjësinë për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut.

Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë ngritur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballlet Shoqëria, për të përcaktuar limite dhe kontrole, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Shoqëria, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saj të administrimit dhe trajnimit, ruan një ambient kontrolli dobiprurës dhe të disiplinuar ku të gjithë punonjësit kuptojnë detyrimet dhe rolet e tyre.

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 4 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Rreziku i kredisë

Gjatë veprimtarisë së biznesit, Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhënë klientëve dhe nga fondet e vendosura pranë institucioneve të tjera financiare dhe zërave të paregjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar (p.sh. angazhimet ndaj huave dhe paradhëniesve të klientëve).

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Shoqërisë nëse një klient apo pala tjetër e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe nga fondet pranë institucioneve të tjera financiare dhe zërat e tjerë të paregjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar. Për qëllime të raportimit të administrimit të rrezikut, Shoqëria konsideron dhe mbledh të gjithë elementet e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si p.sh rreziku i dështimit të një huamarrësi të veçantë, rreziku i vendit dhe sektorit).

Shoqëria administron rrezikun e kredisë në mënyrë të vazhdueshme duke monitoruar drejtpërdrejt limitet e kredisë, portofolin e kredisë dhe përqëndrimin e ekspozimit.

#### Administrimi i rrezikut të kredisë

Drejtimi ka përgjegjësinë për vendimmarrje lidhur me rrezikun e kredisë, ndërkohë VisionFund International ka autoritetin final për të aprovuar politikat përkatëse dhe vendimet më të rëndësishme duke përfshirë:

- *Formulimi i politikave të kredisë* në këshillim me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat mbi kolateralin, vlerësimin e kredisë, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, procedurat dokumentuese dhe ligjore, dhe pajtueshmërinë me kërkesat statutores.
- *Themelimin e strukturës autorizuese* për aprovimin dhe rinovimin e kredive. Nivele aprovimi u janë vendosur Oficerëve të Kredisë në njësitë e biznesit. Kreditë me të mëdha kërkojnë aprovimin e Drejtitimit.
- *Rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë*. Drejtimi vlerëson të gjitha ekspozimet e kredisë të cilat kalojnë limitet e përcaktuara, përpara aprovimit final dhe disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e kredive janë subjekt i të njëjtit proces.
- *Kufizimin e përqendrimeve të ekspozimit* ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive.
- *Zhvillimin dhe mbajtjen e kategorive të rrezikut të Shoqërisë* në mënyrë që të kategorizojë ekspozimet në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë drejtuesit në rreziqet aktuale. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut është adoptuar në përputhje me politikat e VisionFund International. Kategoritë e rrezikut janë subjekt i rishikimeve mujore.
- *Vëzhgimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit*, përfshirë ato për industrinë e zgjedhura dhe llojeve të produkteve.
- *Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësive të specializuara* ndaj pikave të shërbimit për të zhvilluar praktikën me të mira për administrimin e rrezikut të kredisë në të gjithë Shoqërinë.

Çdo njësi biznesi është e detyruar të zbatojë politikat dhe procedurat e kredisë, nëpërmjet autoritetit të aprovimit të deleguar nga Drejtimi. Përqëndrimi i rrezikut të kredisë (nëse regjistruar ose jo në pasqyrën e pozicionit financiar) i cili vjen nga instrumentet financiare ekziston për palët e tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike ose kushte të tjera. Shumica e përqendrimit të rrezikut të kredisë në lidhje me huatë dhënë klientëve vjen nga lloji i klientit.

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë

Hua dhe paradhënie klientëve	2014	2013
Të ristrukturuara	399	360
Pa ditëvonesa	231,800	215,600
1 - 30 ditëvonesa	9,958	10,808
31 - 90 ditëvonesa	4,603	3,869
91 - 180 ditëvonesa	4,241	3,144
181- 365 ditëvonesa	5,030	5,198
Shuma bruto	<b>256,031</b>	<b>238,979</b>
Fondi për zhvlerësim	(9,557)	(9,307)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>246,474</b>	<b>229,672</b>

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 4 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Hua të zhvleresuara

Hua të zhvleresuara janë ato hua për të cilat Shoqëria ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos jetë në gjendje të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të principalit sipas kushteve të kontratës. Shoqëria klasifikon huatë që nuk kanë performance të mire bazuar në instruksionet e grupit.

#### Hua me kushte të ndryshuara

Hua me kushte të ndryshuara janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe sepse Shoqëria mendon që ky përkeqësim është i përkohshëm ajo ka bere lëshime të cilat nuk do t'i bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar, ajo qëndron në të njëjtën kategori, edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

#### Fondi për zhvleresim

Shoqëria vendos një fond për humbjet nga kredia që përfaqëson vlerësimin e saj për humbjet e ndodhura në portofol. Perberesit kryesorë të këtij fondi janë komponenti për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme individualisht, dhe një fond provizioni kolektiv në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual.

Me poshtë është një analizë e vlerës bruto dhe neto (të fondit të zhvlerësimit) të aktiveve të zhvleresuara sipas klasifikimit të rrezikut:

	31 dhjetor 2014		31 dhjetor 2013	
	Bruto	Neto	Bruto	Neto
Të ristrukturuara	399	199	360	-
Pa ditëvonesa	231,800	231,800	215,600	215,600
1 - 30 ditëvonesa	9,958	8,944	10,808	9,695
31- 90 ditëvonesa	4,603	3,435	3,869	2,869
91 - 180 ditëvonesa	4,241	2,096	3,144	1,508
181 - 365 ditëvonesa	5,030	-	5,198	-
<b>Totali</b>	<b>256,031</b>	<b>246,474</b>	<b>238,979</b>	<b>229,672</b>

#### Politika e nxjerrjes jashtë pasqyrave

Shoqëria nxjerr jashtë pasqyrës një kredi (dhe çdo fond për humbjet) kur Drejtimi i Shoqërisë përcakton që një kredi është e pambledhshme. Ky përcaktim arrihet pasi merret në konsideratë informacioni për gjendjen financiare të huamarrësit i cili nuk mund të paguaje detyrimin e tij, ose kur të ardhurat nga shitja e kolateralit nuk janë të mjaftueshme për të paguar të gjithë ekspozimin.

Për balanca me të vogla të kredive vendimet për nxjerrjen jashtë pasqyrës se pozicionit financiar zakonisht bazohen në statusin e ditëvonesave të produkteve specifike. Huatë nxirren jashtë pasqyrës së pozicionit financiar kur ato kanë më shumë se 365 ditëvonesa (2013: 365 ditë).

#### Kolaterali

Shoqëria mban kolateral kundrejt një grupi huash dhe paradhëniesh dhënë klientëve në formën e interesave hipotekare mbi një pronë, ose garanci të tjera të regjistruara mbi ketë aktiv, dhe garancive. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huasë, të cilat rishikohen kur huaja zhvlerësohet individualisht.

Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe garancive të mbajtura kundrejt aktiveve financiare llogaritet të jetë 1,950,656 mijë Lek (31 dhjetor 2013: Lek 2,446,158 mijë Lek) në 31 dhjetor 2014, të cilat përfaqësojnë pengje, garanci personale dhe hipoteke. Kolateralit nuk janë regjistruar në favor të Shoqërisë. Drejtimi ekzekuton rralle kolaterale dhe beson më shumë në karakterin, seriozitetin dhe personalitetin e huamarrësve, gjithashtu edhe në marrëdhënien e krijuar me ta.

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 4 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Përqendrimi i rrezikut sipas sektorit

Shoqëria monitoron përqendrimin e rrezikut të kredisë sipas sektorit të industrisë. Një analizë e përqendrimit sipas sektorëve në datën e raportimit është paraqitur me poshtë:

Sektori i industrisë	31 dhjetor 2014	%	31 dhjetor 2013	%
Agrikulture	36,374	15%	41,393	18%
Blegtori	51,656	21%	78,139	34%
Prodhim	1,981	1%	4,141	2%
Shërbime	34,895	14%	47,894	21%
Tregti	37,502	15%	58,105	25%
Konsumatore	84,066	34%	-	-
<b>Totali</b>	<b>246,474</b>	<b>100%</b>	<b>229,672</b>	<b>100%</b>

#### Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të përballet me vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare të cilat shlyhen duke dhënë para ose një aktiv tjetër financiar.

#### Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i Shoqërisë në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet në kohën e kërkuar si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo duke rrezikuar të dëmtojë emrin e saj. Shoqëria përgatit raporte lidhur me profilin e likuiditetit të aktiveve dhe detyrimeve të tyre financiare dhe detaje të flukseve të tjera monetare të projektuara të cilat vijnë nga biznesi i ardhshëm. Shoqëria mban një portofol aktivesh afatshkurtra likuide, të përberë kryesisht nga instrumentat e investimit afatshkurtra, hua dhe paradhënie dhënë Shoqërive dhe lehtësi të tjera ndërmjet Shoqërive, për tu siguruar se mbahet likuiditet i mjaftueshëm në Shoqëri në tërësi.

Kërkesat e likuiditetit plotësohen nëpërmjet overdrafteve dhe kredive afatshkurtra të marra për të mbuluar ndonjë luhatje afatshkurter dhe burimeve me afatgjata të fondeve për t'u përgjigjur kërkesave strukturore të likuiditetit.

Shoqëria monitoron likuiditetin në baza ditore në mënyrë që të drejtojë detyrimet në kohën e kërkuar.

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Me 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, aktivet dhe detyrimet financiare sipas maturitetit të mbetur paraqiten si me poshtë:

31 dhjetor 2014	Deri në 3 muaj	3 në 6 muaj	6 në 12 muaj	1 në 2 vite	Mbi 2 Vite	Totali
<b>Aktivët</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	16,276	-	-	-	-	<b>16,276</b>
Hua dhënë klientëve	50,439	39,875	40,444	59,632	56,084	<b>246,474</b>
Aktive të tjera	601	50	848	160	61	<b>1,720</b>
<b>Totali aktive</b>	<b>67,316</b>	<b>39,925</b>	<b>41,292</b>	<b>59,792</b>	<b>56,145</b>	<b>264,470</b>
<b>Detyrimet</b>						
Huatë	14,669	13,946	111,344	21,936	50,092	211,987
Detyrime të tjera	1,074	1,478	-	-	-	2,552
<b>Totali detyrimeve</b>	<b>15,743</b>	<b>15,424</b>	<b>111,344</b>	<b>21,936</b>	<b>50,092</b>	<b>214,539</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>51,573</b>	<b>24,501</b>	<b>(70,052)</b>	<b>37,856</b>	<b>6,053</b>	<b>49,931</b>
<b>Rreziku kumulativ i likuiditetit</b>	<b>51,573</b>	<b>76,074</b>	<b>6,022</b>	<b>43,878</b>	<b>49,931</b>	



# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 4 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit (vazhdim)

31 dhjetor 2013	Deri në 3 muaj	3 në 6 muaj	6 në 12 muaj	1 në 2 vite	Mbi 2 vite	Totali
<b>Aktivët</b>						
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	59,803	-	-	-	-	<b>59,803</b>
Hua dhënë klientëve	55,895	43,642	64,521	56,433	9,181	<b>229,672</b>
Aktive të tjera	1,076	71	568	160	211	<b>2,086</b>
<b>Totali aktive</b>	<b>116,774</b>	<b>43,713</b>	<b>65,089</b>	<b>56,593</b>	<b>9,392</b>	<b>291,561</b>
<b>Detyrimet</b>						
Huatë	100,093	21,556	26,088	30,338	42,482	<b>220,557</b>
Detyrime të tjera	1,734	1,390	-	-	-	<b>3,124</b>
<b>Totali detyrimeve</b>	<b>101,827</b>	<b>22,946</b>	<b>26,088</b>	<b>30,338</b>	<b>42,482</b>	<b>223,681</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>14,947</b>	<b>20,767</b>	<b>39,001</b>	<b>26,255</b>	<b>(33,090)</b>	<b>67,880</b>
<b>Rreziku kumulativ i likuiditetit</b>	<b>14,947</b>	<b>35,714</b>	<b>74,715</b>	<b>100,970</b>	<b>67,880</b>	

#### Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë të huamarrësit/emetuesit), do të ndikojë në të ardhurat e Shoqërisë apo vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohe që optimizon kthimin nga rreziku.

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit

Rreziku i kurseve të huaja të këmbimit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë me ndryshimin e kurseve të këmbimit. Transaksionet e Shoqërisë gjenerojnë fitime dhe humbje nga kurset e këmbimit të cilat njihen në humbje ose fitim. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare të Shoqërisë të cilat nuk janë të shprehura në monedhën matëse të Shoqërisë. Shoqëria e menaxhon këtë rrezik duke kontrolluar madhësinë e diferencës ndërmjet vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të shprehura në monedhë të huaj.

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 4 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Pozicionet valutore

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve monetare me 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 sipas monedhës së huaj me të cilën ato janë emetuar paraqitet si më poshtë:

<b>31 dhjetor 2014</b>	<b>Lek</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>Totali</b>
		<b>Shumat ne mije Leke</b>		
<b>Aktivet monetare</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	16,143	12	121	<b>16,276</b>
Hua dhe paradhënie klientëve	246,474	-	-	<b>246,474</b>
Aktive të tjera	1,526	-	194	<b>1,720</b>
<b>Totali i aktiveve monetare</b>	<b>264,143</b>	<b>12</b>	<b>315</b>	<b>264,470</b>
<b>Detyrimet monetare</b>				
Hua	133,175	3,588	75,224	<b>211,987</b>
Detyrime të tjera	2,552	-	-	<b>2,552</b>
<b>Totali i detyrimeve monetare</b>	<b>135,727</b>	<b>3,588</b>	<b>75,224</b>	<b>214,539</b>
<b>Totali Pozicionit neto</b>	<b>128,416</b>	<b>(3,576)</b>	<b>(74,909)</b>	<b>49,931</b>
<b>Pozicioni kumulativ</b>	<b>128,416</b>	<b>124,840</b>	<b>49,931</b>	

<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>Lek</b>	<b>EUR</b>	<b>USD</b>	<b>Totali</b>
		<b>Shumat ne mije Leke</b>		
<b>Aktivet monetare</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	32,041	135	27,627	<b>59,803</b>
Hua dhe paradhënie klientëve	229,672	-	-	<b>229,672</b>
Aktive të tjera	1,907	-	179	<b>2,086</b>
<b>Totali i aktiveve monetare</b>	<b>263,620</b>	<b>135</b>	<b>27,806</b>	<b>291,561</b>
<b>Detyrimet monetare</b>				
Hua	45,820	67,134	107,603	<b>220,557</b>
Detyrime të tjera	3,124	-	-	<b>3,124</b>
<b>Totali i detyrimeve monetare</b>	<b>48,944</b>	<b>67,134</b>	<b>107,603</b>	<b>223,681</b>
<b>Totali Pozicionit neto</b>	<b>214,676</b>	<b>(66,999)</b>	<b>(79,797)</b>	<b>67,880</b>
<b>Pozicioni kumulativ</b>	<b>214,676</b>	<b>147,677</b>	<b>67,880</b>	

#### Informacioni mbi normën efektive të interesit

Norma efektive mesatare e kategorive të rëndësishme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë me 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2014</b>			<b>31 dhjetor 2013</b>		
	<b>USD</b>	<b>EUR</b>	<b>LEK</b>	<b>USD</b>	<b>EUR</b>	<b>LEK</b>
Hua të arkëtueshme nga klientët	n/a	n/a	27%	n/a	n/a	25%
Hua	9%	11%	8%	9%	9%	8%

Megjithëse disa nga huatë janë me interes me të ulët se tregu ose pa interes, Shoqëria i ka njohur ato me vlerën e drejtë. Normat efektive të interesit paraqiten më sipër.

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 4 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Analiza e rëqimit të normës së interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e rëqimit të normave të interesit për aktivet dhe detyrimet monetare të Shoqërisë. Aktivet me norme fikse interesi janë raportuar sipas datës së skeduar të ripagimit të principalit. Shoqëria nuk ka norma të ndryshueshme për aktivet dhe detyrimet. Me 31 dhjetor 2014 dhe 2013, mjetet monetare dhe ekuivalentet me to nuk fitojnë interes.

<b>31 dhjetor 2014</b>	<b>Deri në 3 muaj</b>	<b>3 në 6 muaj</b>	<b>6 në 12 muaj</b>	<b>1 në 2 vite</b>	<b>Mbi 2 vite</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivet</b>						
Hua dhënë klientëve	50,439	39,875	40,444	59,632	56,084	<b>246,474</b>
<b>Detyrimet</b>						
Hua	14,669	13,946	111,344	21,936	50,092	<b>211,987</b>
<b>Pozicioni neto 31 dhjetor 2014</b>	<b>35,770</b>	<b>25,929</b>	<b>(70,900)</b>	<b>37,696</b>	<b>5,992</b>	<b>34,487</b>
<b>Pozicioni kumulativ</b>	<b>35,770</b>	<b>61,699</b>	<b>(9,201)</b>	<b>28,495</b>	<b>34,487</b>	

<b>31 dhjetor 2013</b>	<b>Deri në 3 muaj</b>	<b>3 në 6 muaj</b>	<b>6 në 12 muaj</b>	<b>1 në 2 vite</b>	<b>Mbi 2 vite</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivet</b>						
Hua dhënë klientëve	55,895	43,642	64,521	56,433	9,181	<b>229,672</b>
<b>Detyrimet</b>						
Hua	100,093	21,556	26,088	30,338	42,482	<b>220,557</b>
<b>Pozicioni neto 31 dhjetor 2013</b>	<b>(44,198)</b>	<b>22,086</b>	<b>38,433</b>	<b>26,095</b>	<b>(33,301)</b>	<b>9,115</b>
<b>Pozicioni kumulativ</b>	<b>(44,198)</b>	<b>(22,112)</b>	<b>16,321</b>	<b>42,416</b>	<b>9,115</b>	

#### Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të ndryshojë me ndryshimin e normave të interesit në treg. Shoqëria menaxhon rrezikun e normës së interesit duke monitoruar kushtet e tregut dhe duke aplikuar çmime të nevojshme duke u bazuar në analizën e kostos për çdo produkt. Të gjithë huatë janë me interes të fiksuar dhe shumica e tyre janë me terma me pak ose të barabarta me 2 vjet.

Menaxhimi normave të interesit brenda limiteve të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë duke përdorur skenarë të ndryshme standarde dhe jo standarde të normave të interesit. Skenaret standarde të cilat konsiderohen një herë në muaj përfshijnë një rënie ose rritje paralele me baze pikesh 100 (bp) në të gjitha kurbat e kthimit në botë dhe një rritje ose rënie prej bp 50 në pjesën me të madhe se 12-muaj të të gjitha kurbave të kthimit.

Një analize e ndjeshmërisë së Shoqërisë për një rritje ose ulje të normave të interesit të tregut për fondet e marra hua është si më poshtë:

	<b>100 bp Rritje paralele</b>	<b>100 bp Rënie paralele</b>	<b>50 bp Rritje paralele</b>	<b>50 bp Rënie paralele</b>
Me 31 dhjetor 2014	345	(345)	172	(172)
Me 31 dhjetor 2013	91	(91)	46	(46)

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

---

### 4 Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

#### Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturen e Shoqërisë, dhe nga faktorë të jashtëm përveç rreziqeve të kredisë, tregut dhe likuiditetit si p.sh ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregulluese si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes korporative. Rreziqet operationale lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Shoqërisë dhe janë rreziqe që hasen nga të gjitha shoqëritë biznesit.

Objektivi i Shoqërisë është të menaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë me efektivitetin e përgjithshëm të kostove, si edhe të shmange procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve që adresohen rrezikut operacional i caktohet drejtuesve të lartë në çdo njesi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Shoqërisë për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesa për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve
- pajtimi me kërkesat ligjore dhe rregullative
- dokumentim i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale të identifikuar dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar rreziqet e identifikuara
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimet rregullues të propozuar
- zhvillimi i planeve rastësore
- zhvillimi trajnues dhe profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- lehtësimi i rrezikut, duke përfshirë sigurimin në rastet kur është efektiv.

#### Administrimi i kapitalit

Shoqëria është subjekt i disa kërkesave rregullative me të cilat ajo duhet të pajtohet. VisionFund Albania kërkohet nga banka e Shqipërisë që t'i përmbahet kërkesave të mëposhtme:

- Raporti i kapitalit ndaj totalit të aktivitetit nuk duhet të jetë më i vogël se 5%.
- Raporti i kapitalit ndaj mjeteve fikse materiale dhe jo-materiale neto nuk duhet të jetë më i vogël se 100%.
- Raporti i kapitalit ndaj totalit të huave me probleme nuk duhet të jetë më i vogël se 100%.

Me 31 dhjetor 2014, këto kërkesa të kapitalit janë zbatuar.

Politika e Shoqërisë është të ruhet një baze kapitali brenda limiteve, kontribuar nga aksionaret. Shoqëria njihet nevojën për të patur një balance ndërmjet të ardhurave të larta që janë të mundshme nëpërmjet kredimarrjes së lartë dhe avantazheve dhe sigurisë që lejon një pozicioni të shëndoshë i kapitalit. Nuk ka patur ndryshime të rëndësishme në menaxhimin e kapitalit gjatë periudhës.

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

---

### 5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Shoqëria bën vlerësime dhe gjykime të cilat ndikojnë vlerat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritshmeritë mbi ngjarjet e ardhme të cilat mendohen të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

#### (i) Parimi i vijimësisë

Shoqëria ka akumuluar humbje prej 95,713 mijë Lek (2013: 78,340 mijë lekë) më 31 dhjetor 2014. Në mënyrë që të plotësojë nevojat e saj për likuiditetin dhe për të vazhduar operacionet, Shoqëria ka marrë hua nga VisionFund International ('Mëma') shumë prej 133,175 mijë Lek (2013: 132,833 mijë Lek). Përveç kësaj, masat e ndërmarra nga Mëma në vitin 2013 përfshijnë ndryshime në menaxhimin lokal. Bazuar në këto ndryshime, Shoqëria është përqendruar më shumë në menaxhimin e rrezikut dhe kontrollin e cilësisë së portofolit se sa në vetë rritjen e këtij portofoli. Si rezultat i kësaj periudhe tranzicioni, rritja e portofolit dhe pasojat e lidhura me të, janë shtyrë në vitin pasardhës. Menaxhimi ka rishikuar parashikimet e tij dhe pret që Shoqëria të arrijë pikën e rentabilitetit në tremujorin e fundit të 2015 dhe rezultate pozitive brenda 2016. Për shkak të këtyre pritshmërive, menaxhimi beson se aftësia e kompanisë për të aplikuar parimin e vijimësisë nuk është e zhvlerësuar. Për këtë arsye, Shoqëria i ka përgatitur këto pasqyrat financiare mbi baza vijimësie.

#### (ii) Tatim fitimi

Shoqëria ka aplikuar Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si kuadrin kontabël të saj. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar siguron bazën për regjistrimet kur Shoqëria është subjekt i tatimit mbi korporatat.

#### (iii) Fonde për humbjet nga huatë dhe paradhëniet

Shoqëria rishikon në baze mujore portofolin e kredisë për të përcaktuar humbjet nga zhvlerësimi. Për të përcaktuar nëse një humbje nga kreditë duhet të regjistrohet në humbje ose fitim, Shoqëria gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme e cila tregon se ka rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhme hyrëse të parëse nga portofoli i kredive. Kjo evidence mund të përfshijë të dhëna të dukshme si një ndryshim i pafavorshëm në gjendjen e pagava të huamarrësit ndaj Shoqërisë ose ngjarje ekonomike kombëtare ose lokale të cilat lidhen me mospagimin e kredive.

Drejtimi përdor llogaritje në bazë të eksperiencës së humbjeve të mëparshme për aktivet me karakteristika të riskut të kreditit dhe evidence objektive për fonde të njëjta me ato në portofol kur programojnë flukset e ardhshme monetare. Metodologjia dhe supozimet e bëra për llogaritjen e shumes dhe kohës të flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht për të ulur ndonjë diferencë midis humbjes së llogaritur dhe eksperiencës me humbjen aktuale.

#### (iv) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmime tregu të dukshme, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përmendura në politikat kontabël 3(f)(vi). Për instrumentet financiare që tregtohen rralle dhe kanë transparence të ulët të çmimit, vlera e drejtë është me pak objektive dhe kërkon nivele të shumanshme gjykimi që varen nga likuiditeti, përqendrimi, pasiguria e faktorëve të tregut, supozimet mbi çmimin dhe rreziqe të tjera që ndikojnë instrumentin specifik. Shiko gjithashtu "Vlerësimi i instrumenteve financiare" me poshtë.

### 5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(v) *Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Shoqërisë*

Gjykime kritike kontabël në zbatimin e politikave kontabël të Shoqërisë përfshijnë:

*Vlerësimi i instrumenteve financiare*

Politika kontabël e Shoqërisë për matjen e vlerës së drejtë është trajtuar në shënimin 3(f)(vi).

Shoqëria mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmime të kuotuar në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknika vlerësimi bazuar në të dhëna të vezhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur; çmime të kuotuar në tregje aktive për instrumente të ngjashëm, çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm në tregje që konsiderohen me pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë të dhënat e rëndësishme janë të vezhgueshme në mënyrë direkte ose jo-direkte nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi që përdorin të dhëna të rëndësishme të pavezhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë ato instrumente ku teknika e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk janë të vezhgueshme dhe të dhënat e pavezhgueshme kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar bazuar në çmime të kuotuar për instrumente të ngjashëm ku rregullimet apo gjykimet e rëndësishme të pavezhgueshme kërkohen për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Vlera e drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare që tregtohen në tregje aktive bazohen në çmime tregu të kuotuar ose kuotimeve të çmimit nga tregtaret. Për të gjitha instrumentet e tjerë financiare Shoqëria përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika vlerësimi.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modele të skontimit të flukseve monetare, krahasime me instrumente të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime të dukshme tregu dhe modele të tjera vlerësimi. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijnë në përcaktimin e vlerës së drejtë që reflekton çmimin e instrumentit financiar në datën e raportimit, i cili do të ishte përcaktuar nga pjesëmarrës në treg që veprojnë me kushtet e tregut.

Shoqëria përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare me të thjeshtë dhe me të zakonshëm, si norma e interesit dhe SËAPe të kurseve të këmbimit që përdorin vetëm të dhëna tregu të vezhgueshme dhe kërkojnë pak gjykim apo vlerësim nga drejtuesit. Çmimet e vezhgueshme dhe të dhënat e modeleve janë zakonisht të gjendshme në tregun e borxhit të listuar dhe letrave të kapitalit, derivativeve të kurseve të tregtuara dhe të thjeshta mbi derivativet e kundërt si për shembull SËAP-et e normës së interesit. Disponueshmeria e çmimeve të vezhgueshme të tregut dhe e inpueteve në model redukton nevojën për gjykimin dhe vlerësimin e drejtuesve dhe redukton gjithashtu pasigurinë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmeria e çmimeve të vezhgueshme të tregut dhe të dhënave varion në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur ndaj ndryshimeve bazuar në ngjarje specifike dhe kondita të përgjithshme në tregjet financiare.

Gjykimi dhe vlerësimi i drejtuesve nevojitet zakonisht për zgjedhjen e modelit të vlerësimit do të përdoret, për përcaktimin e flukseve monetare të pritshme për instrumentin financiar që vlerësohet, përcaktimin e probabilitetit për mospagesën apo parapagimet nga pala tjetër dhe përzgjedhjen e normave të përshtatshme të skontimit.

Me 31 dhjetor 2014 të gjithë huatë, të cilat janë matur bazuar në Nivelin 2 të hierarkisë, kanë vlerë të drejtë prej 212,966 mijë Lek (2013: 220,537 mijë Lek) e cila është 978 mijë Lek më shumë se vlera kontabël (2013: 20 mijë Lek me pak).

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 6. Mjete monetare dhe ekuivalentet me to

	2014	2013
Arka	35	639
Llogaritë rrjedhëse	16,241	59,164
<b>Totali</b>	<b>16,276</b>	<b>59,803</b>

### 7. Hua dhe paradhënie për klientët

	2014	2013
Huatë dhënë klientëve, bruto	256,031	238,979
Fond zhvlerësimi	(9,557)	(9,307)
	<b>246,474</b>	<b>229,672</b>

Lëvizjet në fondin e zhvlerësimit për huatë dhe paradhëniet dhënë klientëve paraqiten si më poshtë:

	2014	2013
Më 1 janar	9,307	9,131
Rritja e fondit të zhvlerësimit	8,178	9,081
Të nxjerra jashtë pasqyrës	(7,928)	(8,905)
<b>Në fund të periudhës</b>	<b>9,557</b>	<b>9,307</b>

### 8. Aktivet afatgjata materiale

	Tokë	Automjete	Pajisje dhe mobilje	Kompjuterat	Totali
<b>Kosto</b>					
Më 1 janar 2013	124	16,178	4,020	3,901	24,223
Shtesat	-	-	450	576	1,026
Nxerrje jashtë përdorimi	-	-	-	(189)	(189)
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>124</b>	<b>16,178</b>	<b>4,470</b>	<b>4,288</b>	<b>25,060</b>
Shtesat	-	-	295	280	575
Nxerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>124</b>	<b>16,178</b>	<b>4,765</b>	<b>4,568</b>	<b>25,635</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>					
Më 1 janar 2013	-	(6,926)	(2,163)	(2,210)	(11,299)
Zhvlerësimi i vitit	-	(2,540)	(420)	(466)	(3,426)
Nxerrje jashtë përdorimi	-	-	-	19	19
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>-</b>	<b>(9,466)</b>	<b>(2,583)</b>	<b>(2,657)</b>	<b>(14,706)</b>
Zhvlerësimi i vitit	-	(2,519)	(443)	(478)	(3,440)
Nxerrje jashtë përdorimi	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>-</b>	<b>(11,985)</b>	<b>(3,026)</b>	<b>(3,135)</b>	<b>(18,146)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>					
Më 31 dhjetor 2013	124	6,712	1,887	1,631	10,354
<b>Më 31 dhjetor 2014</b>	<b>124</b>	<b>4,193</b>	<b>1,739</b>	<b>1,433</b>	<b>7,489</b>

Toka përfaqëson vlerën e kolateralit të një kredie të pakthyeshme, pronësia e së cilës është marrë në emër të Shoqërisë. Vlera e drejtë e këtij aktivi është përcaktuar me çmimin e tregut.

Vlera kontabël e aktiveve të marra përmes qirasë financiare (shiko shënimin 10) më 31 dhjetor 2014 ishte 3,588 mijë Lek (2013: 5,587 mijë Lek)

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 9 Aktive të tjera

	2014	2013
Të arkëtueshme	375	368
Shpenzime të parapaguara	1,167	1,098
Parapagim i tatimit mbi fitimin	164	165
Të tjera	14	455
<b>Totali</b>	<b>1,720</b>	<b>2,086</b>

### 10 Hua dhe qira financiare

	2014	2013
<b>Huatë</b>		
World Vision Albania	-	2,820
VisionFund International	133,175	133,029
Kiva Microfunds	75,224	58,600
MicroCredit Enteprise	-	20,521
<b>Qiraja financiare</b>		
Credins Leasing	3,588	5,587
<b>Totali</b>	<b>211,987</b>	<b>220,557</b>

Detyrimi për qiranë financiare që lidhet me mjetet e transportit të blera nga Shoqëria përmes qirasë financiare të marrë nga Credins Leasing (shiko shënimin 8).

Rakordimi ndërmjet pagesave minimale të ardhshme të qirasë dhe vlerës aktuale ('VA') të tyre më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet në tabelën më poshtë:

	2014			2013		
	VA e pagesave minimale të qirasë	Interesi	Pagesat minimale të ardhshme të qirasë	VA e pagesave minimale të qirasë	Interesi	Pagesat minimale të ardhshme të qirasë
Deri 1 vit	2,218	219	2,437	2,019	397	2,416
1 deri 5 vjet	1,370	39	1,409	3,568	258	3,826
	<b>3,588</b>	<b>258</b>	<b>3,846</b>	<b>5,587</b>	<b>655</b>	<b>6,242</b>

### 11 Detyrime të tjera

	2014	2013
Tatime dhe sigurime shoqërore	750	1,332
Shpenzime të përlogaritura	1,010	604
Të tjera	792	1,188
<b>Totali</b>	<b>2,552</b>	<b>3,124</b>



# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 12 Kapitali aksionar

Shoqëria zotërohet nga VisionFund International. Më 31 dhjetor 2014, totali i kapitalit aksionar të autorizuar përbëhet nga 156,200 aksione (2013: 156,200 aksione) me një vlerë nominale prej 1,000 Lek për aksion (2013: Lek 1,000 për aksion).

### 13 Të ardhura neto nga interesat

	2014	2013
<i>Të ardhura nga interesi</i>		
Interesa nga huatë e klientëve	69,243	64,815
	<b>69,243</b>	<b>64,815</b>
<i>Shpenzime për interesa</i>		
Interesa për huatë	(24,318)	(19,334)
	<b>(24,318)</b>	<b>(19,334)</b>
<b>Të ardhura neto nga interesat</b>	<b>44,925</b>	<b>45,481</b>

### 14 Të ardhura të tjera

	2014	2013
Të ardhura nga huatë e regjistruara si të humbura	3,430	2,476
Te ardhura nga grante	3,694	4,308
Te ardhura nga njohja e huave pa interes nga Kiva (shenimi 10)	4,037	2,158
Të tjera	207	152
<b>Totali</b>	<b>11,368</b>	<b>9,094</b>

### 15 Shpenzime personeli

	2014	2013
Paga bruto	25,023	27,118
Kompensime për drejtimin	2,709	1,931
Sigurime shoqërore	4,882	4,428
Bonuse dhe përfitime të tjera	2,082	1,296
<b>Totali</b>	<b>34,696</b>	<b>34,773</b>

Më 31 dhjetor 2014, Shoqëria punësonte 34 (2013: 37) punonjës.

### 16 Shpenzime të tjera

	2014	2013
Konsulencë, shërbime ligjore dhe asistence teknike	3,679	5,068
Qira	3,515	4,108
Shpenzime karburanti	2,160	2,468
Riparime dhe mirëmbajtje	1,865	1,781
Shpenzime komunikimi	1,466	1,714
Shpenzime të tjera operative	1,054	1,094
Shpenzime transporti	989	1,053
Pajisje zyre	889	1,133
Shpenzime komunale	628	961
Komisione bankare	431	489
Shpenzime promovimi	382	197
Shpenzime trajnimit	91	139
Taksa lokale	376	345
Sigurimi i paisjeve	34	252
<b>Totali</b>	<b>17,559</b>	<b>20,802</b>

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 17 Tatimi mbi fitimin

Tatimi i llogaritur mbi rezultatin e Shoqërisë para fitimit ndryshon nga shuma që duhet të ishte duke përdorur normën mesatare të ponderuar të tatimit, e cila aplikohet mbi rezultatin e Shoqërisë si më poshtë:

	Norma tatimit	2014	Norma tatimit	2013
Humbja para tatim fitimit		<b>(17,373)</b>		<b>(10,490)</b>
Tatimi mbi fitimin me normën statutores me 15%/10%	15%	(2,606)	10%	(1,049)
Shpenzime të pazbritshme	-4%	736	(1%)	92
Humbje nga tatimi të panjohura	-11%	1,870	(9%)	957
<b>Totali</b>	<b>0%</b>	<b>-</b>	<b>0%</b>	<b>-</b>

Tatimi i shtyrë llogaritet duke përdorur normën 15%. Sipas ligjit shqiptar periudha e mbartjes së humbjes nga tatimi është tre vjet. Shoqëria nuk ka njohur aktive tatimore të shtyra për këto humbje nga tatimi apo diferenca të tjera të përkohshme, sepse nuk është e mundur që aktivet tatimore të shtyra do të përdoren.

Humbjet tatimore detajohen si më poshtë:

Viti	2011	2012	2013	Humbjet tatimore te akumuluar
Humbjet tatimore	1,344	957	1,870	<b>4,171</b>
Përdorimi	-	-	-	-
<b>Neto</b>	<b>1,344</b>	<b>957</b>	<b>1,870</b>	<b>4,171</b>

# VisionFund Albania

## Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 18 Transaksionet me palët e lidhura

Gjatë drejtimit të biznesit, Shoqëria ka hyrë në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura. Palët e lidhura me të cilat Shoqëria ka kryer transaksione biznesi janë si më poshtë:

	2014	2013
<b>VisionFund International</b>		
Shpenzime operative	21,528	17,357
Të arkëtueshme	195	177
Detyrime të tjera	133,175	133,029
<b>World Vision Albania</b>		
Huatë	-	2,820
<b>Shpërblimi i drejtimit</b>		
Shpërblimi, përfshirë bonuse dhe përfitime të tjera	2,393	2,098

Nga shuma totale e shpenzimeve të interesit, shuma prej 15,283 mijë Lek (2013: 17,357 mijë Lek), lidhet me huatë e marra nga palët e lidhura, të cilat paraqiten më sipër.

### 19 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

#### *Procedura ligjore*

Shoqëria përballet me procese gjyqësore dhe procedura ligjore të cilat rrjedhin nga aktiviteti i zakonshëm i biznesit. Drejtimi mendon se këto procese nuk do të sjellim humbje materiale në lidhje me pretendimet ligjore dhe në fund të vitit 31 dhjetor 2014 nuk ka pretendime për çështje ligjore.

#### *Angazhime për qiratë operative*

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria është pjesë e disa marrëveshjeve të qirasë operative lidhur me qiranë e zyrave, të cilat përfundojnë në data të ndryshme. Pagesat minimale të ardhshme për marrëveshjet kryesore janë si më poshtë:

	2014	2013
Me pak se 1 vit	315	246
<b>Totali</b>	<b>315</b>	<b>246</b>

#### *Çështje ligjore*

Shoqëria nuk është e përfshirë në ndonjë mosmarrëveshje ligjore apo çështje ligjore që rezulton nga aktiviteti i zakonshëm i biznesit deri në fund të vitit.

### 20 Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje pas datës së raportimit, e cila do të kërkonte korrigjime apo shënime të tjera sqaruese në pasqyrat financiare.